

Zëra më të fortë për zgjedhje më të mira - Qendrat Rinore në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi**Duration:** 15.11.2024 - 14.11.2027**Countries:**

Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, Shqipëria

EU contribution: € 978 439**Total budget:** € 1 087 155**Implementer:**

NVO Prima, Youth Alliance Krushevo, Community Volunteers Foundation, Beyond Barriers, Institute for Youth Development KULT, Democracy for Development

Website(s): youthwbt.eu/**Project description:**

Rrjeti i Qendrave Rinore për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë është i përkushtuar për t'u dhënë fuqi të rinjve që të luajnë rol aktiv në formësimin e së ardhmes së komuniteteve të tyre dhe të rajonit. Përmes këtij projekti, synojmë të krijojmë një mjedis më gjithëpërfshirës që mbështet pjesëmarrjen sociale, ekonomike dhe politike të vajzave dhe djemve të rinj në të gjithë Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë.

Fokusi kryesor i projektit është te të rinjtë e marginalizuar – përfshirë vajzat dhe gratë e reja, të rinjtë romë, të rinjtë me aftësi të kufizuara, pakicat dhe ata që jetojnë në zonat rurale. Shumë prej këtyre të rinjve kanë qasje të kufizuara në informacion, mundësi apo nisma qytetare. Duke i përfshirë ata drejtpërdrejt, projekti nxit angazhimin e tyre në jetën komunitare dhe i ndihmon të marrin pjesë në procesin e integritimit në BE dhe në transformimin më të gjerë demokratik të shoqërive të tyre.

Ne besojmë se qytetaria aktive dhe pjesëmarrja qytetare janë thelbësore për ndryshim të qëndrueshëm. Organizatat e shoqërisë civile (OJQ-të) luajnë rol kyç në sigurimin që zërat e qytetarëve të dëgjohen dhe që reformat të jenë gjithëpërfshirëse, transparente dhe efektive. Kur OJQ-të janë të ndërlidhura mirë dhe të pajisura me aftësitë e duhura, mund të mobilizojnë komunitetet, të nxisin dialogun dhe të avokojnë për politika që pasqyrojnë nevojat dhe aspiratat reale të të rinjve.

Expected results:

- Politika më të mira për të rinjtë: Projekti do të ndihmojë në përmirësimin e hartimit të politikave dhe zbatimin e reformave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi. Një arritje kyçe do të jetë krijimi i Indeksit të Pjesëmarrjes së të Rinjve (YPI) - një mjet inovativ që mat se sa aktivisht të rinjtë marrin pjesë në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore në të gjithë rajonin.
- Organizata rinore më të forta dhe më të lidhura: Projekti do të forcojë aftësitë dhe bashkëpunimin e 88 organizatave joqeveritare (OJQ), duke i ndihmuar ato të punojnë së bashku në mënyrë më efektive dhe të kenë ndikim më të madh në vendimet që prekin gratë dhe burrat e rinj.
- Angazhim më aktiv dhe i dukshëm i të rinjve: Projekti do të rrisë aftësinë e OJQ-ve për të rritur ndërgjegjësimin publik, për të mobilizuar qytetarët dhe për të promovuar pjesëmarrjen e të rinjve në jetën komunitare dhe qytetare, duke siguruar që zërat e të rinjve të dëgjohen dhe të vlerësohen.

